

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Agnesa Hasimja – Pasha

**KOMPETENCA DHE PERFORMANCA  
GRAMATIKORE E NXËNËSVE TË  
KLASAVE IX DHE XII NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2021

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

MA Agnesa Hasimja - Pasha

**GRAMMAR COMPETENCE AND  
PERFORMANCE OF PUPILS OF IX AND XII  
GRADES IN KOSOVO**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA AGNESA HASIMJA – PASHA

**KOMPETENCA DHE PERFORMANCA  
GRAMATIKORE E NXËNËSVE TË  
KLASAVE IX DHE XII NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:

Prof. asoc. dr. Rrahman Paçarizi

Prishtinë, 2021

## Përmbledhje

Bazuar në rezultatet e testimeve që bëhen zakonisht pas përfundimit të cikleve 9 dhe 12-vjeçar, apo rezultateve të Pisa-s etj., duke lënë jashtë këtij interpretimi të shprehurit e të rinjve në gjuhën e shkruar apo të folur rëndom nëpër mediet televizive apo sociale, tregojnë për formim përgjithësisht jo të kënaqshëm gjuhësor të tyre. Nxënësit dhe nxënëset kanë vështirësi për t'i formuluar dhe shprehur mendimet e tyre në mënyrë të qartë, pa bërë gabime gramatikore, të asaj natyre, që çojnë në paqartësi kuptimore të ndryshme lidhur me përshkrimin, argumentimin mbi sende e dukuri të përgjithshme.

Objekt i punimit të doktoratës “Kompetenca dhe performanca gramatikore e nxënësve të klasave IX dhe XII në Kosovë” është pikërisht paraqitja e zhvillimit dhe e reflektimit të aftësisë gramatikore të nxënësve dhe të nxënësve të klasave IX dhe XII në Kosovë, duke qenë se përbërësit gramatikorë, bashkë me komponentët e tjerë luajnë rol në zhvillimin e aftësive komunikuese të tyre.

Problemet me shkathtësitë gramatikore, të nxënësve të gjuhës etj. kanë natyrë komplekse, dhe lidhen me një sërë faktorësh të ndryshëm. Por në këtë punim, meqë trajtohet kompetenca dhe performanca gramatikore e nxënësve/nxënësve, jemi përqendruar më shumë në zbatimin dhe të nxënësve të gramatikës në kontekstin shkollor. Prandaj, një qasje ndërdisiplinore ka qenë e domosdoshme të rrokët. Në këtë punim, trajtimi që i bëhet gjuhësisë më vete në tekstet shkollorë mbështetet në konceptet dhe parimet e gjuhësisë teorike; për të vazhduar me fusha të gjuhësisë aplikative, si: psikolinguistikën, për teorinë e të nxënësve të gjuhës së fëmijëve; didaktikën, për procesin mësimor, metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe; objektivat e kurrikulës bërthamë e të orëve mësimore; përgatitjen profesionale të mësimdhënësve dhe të mësimdhënësve të gjuhës shqipe; sociolinguistikën, me rrethimin jetësor, ndikimin gjuhësor të shoqërisë, si dhe deficitin social.

Lidhur me këto që u thanë, kemi shtruar disa hipoteza, si: 1.Njohuritë për ta zbatuar gramatikën e shqipes në komunikimin e shkruar, të nxënësve dhe nxënësve të klasave IX dhe XII në Kosovë, janë në shpërputhje me objektivat e kurrikulës përkatëse; 2.Shqyrtimi dhe interpretimi i njësive të gramatikës në orët e Gjuhës shqipe është preskriptiv; 3.Metodat e

mësimdhënies janë të papërditësuara dhe nuk realizohen në tërësinë e tyre; 4.Kompetenca gramatikore e mësimdhënësve të Gjuhës shqipe është e pamjaftueshme.

Punimi i doktoratës „Kompetenca dhe performanca gramatikore e nxënësve të klasave IX dhe XII në Kosovë“ përbëhet nga gjashtë kapituj gjithsej.

Në kapitullin e parë „Qasje të ndryshme ndaj gramatikës“, spikatet rëndësia që pati kalimi i trajtimit preskriptiv ndaj gramatikës në studimet deskriptive të saj, për të hapur rrugë në studimin e gjuhës në një spektër (më)shumëdimensional, si dhe përshkruhet historia e gramatologjisë shqiptare dhe përpjekjet e para për të sjellë studime mbi gramatikën e shqipes.

Kapitulli i dytë “Kompetenca dhe performanca gramatikore” sjell disa pikëpamje teorike mbi konceptet kompetencë dhe performancë gramatikore për të vazhduar më pas edhe me kompetencën komunikuese. Përkufizimi çomskian se aftësia/kompetenca është diçka që një folës di intuitivisht për gjuhën e tij u plotësua nga studiues të tjerë më vonë. Në këtë punim, kompetenca gramatikore e nxënësve është konsideruar si njohje dhe zhvillim i aftësisë gramatikore me të cilën janë të pajisur nxënësit, varur nga një tërësi faktorësh kontekstualë. Gjithashtu, një seksion i veçantë në këtë kapitull i kushtohet kompetencës komunikative, që është një ndër gjashtë kompetencat kryesore të parapara për realizim në Kornizën kurrikulare të Kosovës.

Në kapitullin e tretë “Drejtimit dhe teoritë kryesore të të nxënësve të gjuhës dhe ndikimi i tyre në arsim” janë trajtuar drejtimit kryesore të të nxënësve të gjuhës: nativizmi dhe bihejviorizmi, si dhe disa nga teoritë e të nxënësve, si kognitivizmi dhe konstruktivizmi. Qasja bihejvioristike mbështet idenë se mësimi i një gjuhe është i njëjtë me mësimin e çfarëdolloj gjëje tjetër që ka për bazë formimin e zakoneve, të cilat në vetvete vijnë si rrjedhojë e marrëdhënies stimul-reagim. Ky drejtim ka ndikuar për disa dekada me radhë edhe në mësimdhënien e gjuhës shqipe, gjurmët e së cilës vërehen edhe sot, ani pse në ndryshimet e përgjithshme që janë bërë në kurrikulë zë vend qasja konstruktiviste në mësimin e gjuhës e edhe të lëmëve të tjera në arsim.

Në kapitullin e katërt „Analizë e teksteve parauniversitare të gjuhës shqipe“ zënë vend shpërndarja e njësive gramatikore nga klasa në klasë, si dhe trajtimi mbi disa nga njohuritë gramatikore të shtejlluara në tekstet shkollore të gjuhës shqipe nga klasa VI deri në klasën XII. Mësimi i gramatikës është pothuajse krejtësisht teorik, më vete, preskriptiv, jo në funksion të zhvillimit të shkathtësisë së komunikimit të nxënësve/nxënësve.

Shtrirja e çështjeve gramatikore në planprogramet dhe tekstet shkollore nuk është e njëtrajtshme në cilin shkollor dymbëdhjetëvjeçar të lëndës së Gjuhës shqipe. Planprogramet e shkollës së mesme të ulët janë më të ngjeshura dukshëm nga sasia e njësive gramatikore krahasur me planprogramet e shkollës së mesme të lartë. Kështu, i është hapur rrugë krijimit të boshllëqeve gjuhësore të nxënësve/nxënëseve në sistemin arsimor që ka krijuar një formim të mangët të njohurive dhe të shkathtësive gramatikore të shqipes. Pra, paraqitja dhe shqyrtimi i planprogrameve të gjuhës shqipe për klasat IX dhe XII; por edhe objektivat mësimorë, teknikat që përdorin mësimdhënësit e gjuhës shqipe gjatë orëve mësimore, rrjedhimisht të gramatikës, si dhe pasqyrimi dhe interpretimi i njohurive gramatikore të mësimdhënësve të gjuhës shqipe, janë përfshirë në kapitullin e pestë të titulluar „Të nxënit e lëndës së gjuhës shqipe në shkollë“.

Ndërkaq, në kapitullin e gjashtë „Zotërimi i gramatikës së shqipes nga nxënësit e klasave IX dhe XII“ jepen të dhënat dhe interpretimi mbi njohuritë e nxënësve mbi gramatikën e shqipes, dhe shkathtësitë gramatikore të tyre për t'i përdorur ato në shqipen e shkruar.

Fjalët kyçe: kompetencë, performancë, gramatikë, të nxënit, mësimdhënie, mësimnxënie, kurrikulë, deficit gjuhësor etj

## **Resumé**

Based on the results of testing, which are usually done after the completion of 9 and 12 –year cycles, or of Pisa results etc., leaving outside this interpretation the expression of young people in the written or spoken language, usually on television or social media, they tell about their generally unsatisfactory linguistic formation. The pupils have difficulties in formulating and expressing their thoughts in a clear way, without making grammatical mistakes, of such a nature, which lead to different semantical ambiguities regarding the description, reasoning on general things and phenomena.

Object of the doctoral dissertation (thesis) “Grammar Competence and Performance of Pupils of IX and XII Grades in Kosovo” is exactly the demonstration of development and reflection of grammatical capability of pupils of the IX and XII grades in Kosovo, since the

grammatical constituents, along with the other components play a role in the development of their communication skills.

Problems with grammatical skills, language acquisition etc. have a complex nature, and they are related to a series of different factors. However, in this dissertation (thesis), since it is treated the grammatical competence and performance of pupils, we are more focused on the implementation and acquisition of grammar in the school context. Therefore, an interdisciplinary approach has been indispensable to be tackled. In this sense, the treatment that is done to the linguistics on its own in school textbooks is based on the concepts and principles of theoretical linguistics; in order to continue with the fields of applied linguistics, such as: psycholinguistics, about the theories of children language acquisition; didactics, about the teaching process, methodology of children language acquisition; didactics, about the teaching process, methodology of teaching Albanian language; objectives of core curricula and of lessons; professional preparation of male and female teachers of Albanian language; sociolinguistics, with the living environment, linguistic influence of society, as well as social deficit.

Related to what was said above, we have presented several hypotheses, including: 1. Knowledge to implement the grammar of Albanian in written communication, in pupils of IX and XII grades in Kosovo, are in discrepancy with the goals of the respective curriculum; 2. Treatment and interpretation of grammar units in the lessons of Albanian language is prescriptive; 3. Teaching methods are unupdated and are not implemented in their entirety; 4. Grammar mastery of Albanian language teachers is insufficient.

The doctoraal dissertation (thesis) “Grammar Competence and Performance of Pupils of IX and XII Grades in Kosovo” consists of altogether six chapters.

In the first chapter „Different approaches to grammar“, in its first subchapter, it is highlighted the importance that the passing of prescriptive treatment had against grammar in descriptive studies, to open way to the study of language in a multidimensional spectrum, as well as in the second subchapter it is described the history of Albanian grammatology and the first attempts to introduce studies on the grammar of Albanian.

The second chapter „Grammatical competence and performance“ introduces some theoretical aspects on the concepts grammatical competence and performance, in order to continue then also with the communication competence. The Chomskian definition that the

skill/competence is something a speaker knows intuitively about his language was completed later by other scholars. In this dissertation (thesis), the grammatical competence of pupils is considered as a cognition and development of grammatical skill by which the pupils are supplied, depending on a series of contextual factors. Also, a special section in this chapter is dedicated to the communicative competence, which is one of the six principal competences for the realization in the Curricular Framework of Kosovo.

In the third chapter “Directions and main theories of language acquisition and their influence on education” have been treated the main streams of language acquisition: nativism and behaviourism, as well as some theories of learning, such as cognitivism and constructivism. The behaviouristic approach supports the idea that the acquisition of a language is the same with the acquisition of anything else that has as a basis the habits building, which in themselves come as a result of the relation stimuli-reaction. This stream has influenced for several consecutive decades also on the teaching of Albanian language, whose traces can be observed even today, although in the general changes that have been made in the curriculum a place is occupied by the constructivist approach in language acquisition also of other fields in education.

In the fourth chapter „Analysis of preuniversity textbooks of the Albanian language“ is included also the distribution of grammatical units from a grade to a grade, as well as the treatment on several grammatical knowledge developed in the preuniversity textbooks of the Albanian language from the VI grade to the XII grade. The teaching of grammar is almost completely theoretical, in itself, prescriptive, not in function of the development of communication skills of pupils.

The extension of grammatical issues in the curricula and school textbooks is not uniform in the twelve-year school cycle of the subject of Albanian language. The curricula of the secondary low school are considerably more condensed from the quantity of grammatical units compared to curricula of the secondary high school. Thus, it has been opened way to the creation of gaps of pupils in the educational system, which has created a deficient formation of grammatical knowledge and skills of the Albanian language. Hence, the presentation and treatment of curricula of the Albanian language for the IX and XII grades; but also educational goals, techniques used by the Albanian language teachers during the lessons, consequently of grammar, as well as the depiction and interpretation of grammatical knowledge of the



Albanian language teachers, have been included in the fifth chapter entitled „Teaching Albanian language at school“.

Whereas, in the sixth chapter „Mastering the grammar of the Albanian language by the pupils of IX and XII grades“ are given the data and interpretation on the knowledge of pupils about the Albanian grammar and their grammatical skills to be used by them in the written Albanian.

Key words: competence, performance, grammar, acquisition, teaching, learning, curriculum, linguistic deficit, etc.